



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463/01-74093, dt. 27 shtator 2024

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Fatmir (Asllan) Zymberi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 27 shtator 2024, merr këtë:

**VENDIM
Nr. 50/2024**

Mbi Miratimin për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Fatmir (Asllan) Zymberi me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e çështjes së pronës e cila ndodhet në hyrje/oborrin e shkollës fillore “Skender Çeku” në fshatin Qyshk.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e çështjes së pronës e cila ndodhet në hyrje/oborrin e shkollës fillore “Skender Çeku” në fshatin Qyshk.
- II. Parcela kadastrale nr.92-25 në sipërfaqe prej 350m² ZK Qyshk pronë e pronarit Fatmir Zymberi do të merret për nevoja të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e çështjes së pronës e cila ndodhet në hyrje/oborrin e shkollës fillore “Skender Çeku” në fshatin Qyshk, dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr.91-18 në sipërfaqe prej 419m² ZK Qyshk pronë Komuna Pejë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 09.08.2024.
 - Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr.91-18 në sipërfaqe prej 419m² ZK Qyshk është vlerësuar 40.00 €/m², që i bie totali 16,760.00 €.
 - Prona private e Fatmir Zymberit, ngastra kadastrale nr.92-25 në sipërfaqe prej 350m² ZK Qyshk është vlerësuar 45.00 €/m², që i bie totali 15,750.00 €.
 - Ashtu që Fatmir Zymberi obligohet Komunës së Pejës t’ia kompenzoj diferencën në shumën prej 1,010.00 €.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t’i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësoro–Juridike.

VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në Web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

